



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 132

Tiranë – E martë, 19 korrik 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 508, datë 6.7.2016	Për rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve brenda buxhetit të vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për marrjen e masave urgjente për parandalimin e sëmundjes së dermatozës nodulare të gjedhit.....	10471
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, nr. 3453, datë 4 7.2016	Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.....	10471
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Energjisë dhe Industrisë, ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Financave, nr. 3946, datë 10.6.2016	Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë lëndëve djegëse të lëngëta të mesme të rënda (<i>Gas oil</i>), lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (<i>Heavy Fuel Oil</i>) dhe lëndëve djegëse të lëngëta marinë (<i>Marine Fuel</i>).....	10476
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 74, datë 6.7.2016	Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore”.....	10477
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 75, datë 6.7.2016	Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”.....	10477
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 80, datë 6.7.2016	Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit raportues të unifikuar”.....	10478
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 81, datë 6.7.2016	Për miratimin e rregullore “Për kontrollin për autenticitet dhe kriteret e riciklimit të monedhave metalike shqiptare”.....	10479
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 106, datë 29.6.2016	Për miratimin e një ndryshimi në “Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike”.....	10483

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 107, datë 29.6.2016	Mbi fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k. me nr. 3, Seria.PVO3K, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 69, datë 12.12.2007.....	10483
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 108, datë 29.6.2016	Mbi kërkesën e shoqatës shqiptare të energjisë së rinovueshme për rishikimin/pezullimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 77, datë 7.6.2016, “Për fillimin e procedurave për miratimin e rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”.....	10484
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 109, datë 29.6.2016	Mbi miratimin e rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike.....	10485
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 111, datë 1.7.2016	Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2016.....	10503
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban, nr. 3781, datë 4.7.2016	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit, “Rikonstruksion i rrugës “Mujo Ulqinaku” dhe “Rehabilitimi i fasadave”, Fier.....	10504
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban, nr. 3887, datë 8.7.2016	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim asfaltim rrugë e sheshe, blloqet e banimit Sheja+tregu i qytetit, Shkumbini dhe Ushtaraku”, Librazhd.....	10504

**VENDIM****Nr. 508, datë 6.7.2016**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH
NDËRMJET PROGRAMEVE BRENDA
BUXHETIT TË VITIT 2016, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, PËR
MARRJEN E MASAVE URGJENTE PËR
PARANDALIMIN E SËMUNDJES SË
DERMATOZËS NODULARE TË
GJEDHIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, dhe të pikës 1, të nenit 46, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve brenda buxhetit të vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për marrjen e masave urgjente për parandalimin e sëmundjes së dermatozës nodulare të gjedhit, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit” shtohen 84 000 000 (tetëdhjetë e katër milionë) lekë, shpenzime korrente;

b) Në programin buxhetor “Zhvillimi rural duke mbështetur bujqësinë, blegtorinë, agroindustrinë dhe marketingun” pakësohen 84 000 000 (tetëdhjetë e katër milionë) lekë, shpenzime korrente nga skema mbështetëse për bujqësinë.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

UDHËZIM**Nr. 3453, datë 4.7.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË
UDHËZIMIN NR. 1649, DATË 16.8.1999,
“MBI PLOTËSIMIN E DISA KUSHTEVE
TË VEÇANTA NË TRANSPORTIN
RRUGOR TË UDHËTARËVE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 9, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Paragrafi “Hyrje”, ndryshon si më poshtë:

“Mjetet motorike të transportit rrugor të udhëtarëve, janë të detyruar të kryejnë në kohë dhe me rezultat pozitiv kontrollin teknik të detyrueshëm, periodik dhe vjetor, në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 11.3.2010, “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, të ndryshuar”.

Gjithashtu, këto mjete rrugore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, duhet të plotësojnë dhe kushtet e tjera, që lidhen me sigurinë e udhëtarëve dhe komoditetin e udhëtimit të tyre, si më poshtë:”

2. Në kapitullin IA “Sigurimi i udhëtimit”, shtohen pikat 11 dhe 12, me përmbajtje si më poshtë:

“11. Të kenë të instaluar kompletin e pajisjeve për situata emergjente (fikse zjarri, çekiç për thyerje xhamash etj.) sipas manualit të prodhuesit.

“12. Autobusët, të cilët kryejnë transportin e udhëtarëve në linjat qytetëse, rrethqytetëse, ndërqytetëse, linjat e transportit ndërkombëtar dhe shërbimet e transportit të rastit/turistik të udhëtarëve, (ndërkombëtar dhe brenda vendit), duhet përveç derës së drejtuesit të autobusit të kenë minimalisht dy dyer, përfshirë daljen e emergjencës.

3. Në kapitullin IB, pika 1 riformulohet si vijon:

“1. Pamja e jashtme e autobusëve duhet të jetë e pastër, pa njolla e deformime apo shtypje të mbulesës së tyre dhe me ngjyrën sipas lejes së qarkullimit.



Mbi autobus nuk lejohet të vendosen shkrime të tjera, qofshin me karakter tregtar apo për çdo qëllim tjetër, përveç emrit të subjektit transportues (neni 23, i ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neni 56, i VKM-së nr. 153, datë 7.4.2000, “Rregullore e zbatimit të Kodit Rrugor”, i ndryshuar).

Pamja e jashtme dhe e brendshme e autobusit është subjekt për përfitim të aktvlerësimit për plotësimin e kushteve në komoditetin e autobusëve në transportin e udhëtarëve.

Hapësira e brendshme e autobusit të jetë e pastër nga ana higjienike dhe me komoditetin e prodhimit.”

4. Paragrafi i dytë i pikës 8.a, kapitulli IB “Komoditeti i udhëtimit”, ndryshon si më poshtë:

“Akti i vlerësimit në plotësimin e kushteve të komoditetit të autobusëve në transportin e udhëtarëve brenda vendit lëshohet çdo vit, pasi autobusi ka kryer me rezultat pozitiv kontrollin teknik, të detyrueshëm, në qendrën e kontrollit teknik, të miratuar nga ministri përgjegjës për transportin dhe është pajisur me certifikatën e kontrollit teknik, në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 11.3.2010, “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, të ndryshuar.”

5. Paragrafi i parë dhe i tretë i pikës 9, kapitulli IB, ndryshojnë si më poshtë:

“Autobusët e transportit ndërkombëtar dhe brenda vendit të udhëtarëve, në linja të rregullta, si dhe në shërbimet e transportit të rastit/turistik të udhëtarëve, duhet të jenë të pajisur me sistem kondicionimi dhe qendër zëri, në përputhje me tipin e miratuar. Çdo ndenjësë e autobusit duhet të jetë e pajisur me rripin e sigurimit. Autobusët e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve në linja të rregullta, duhet të kenë dhe tualet (WC, lavaman të vogël dhe solucion pastrimi), në përputhje me tipin e miratuar, si dhe të jenë në gjendje funksionale.

Aktivlerësimi për plotësimin e kushteve në komoditetin e autobusëve në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, lëshohet çdo vit, pasi autobusi ka kryer me rezultat pozitiv kontrollin teknik të detyrueshëm, në qendrën e kontrollit teknik të miratuar nga ministri përgjegjës për transportin dhe është pajisur me certifikatën e kontrollit teknik, në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 11.3.2010, “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, të ndryshuar.”

6. Në kapitullin II “Kriteret bazë për hartimin e rregullores së udhëtimit”, pika 16 ndryshon si më poshtë:

“16. Personat e caktuar për kryerjen e transportit, që janë në kontakt me udhëtarët, duhet:

- të jenë të pajisur me një dokument identifikues të dallueshëm qartë gjatë ushtrimit të shërbimit;

- të jenë të aftë për të menaxhuar një situatë emergjente, vlerësimin e situatës për shmangien e ndërlikimeve të një aksidenti, thirrjen për ndihmë dhe dhënien e ndihmës së parë, reagimi në rast zjarri, evakuimi i udhëtarëve të autobusit, duke siguruar mbrojtjen e të gjithë udhëtarëve;

- të informojnë udhëtarët lidhur me detajet e shërbimit të transportit të ofruar, përpara dhe gjatë udhëtimit (për çmimet dhe tarifat, kushtet e transportit, veprimet në rast të një situatë emergjente etj.);

- të kenë njohuri mbi dispozitat ligjore për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të sanksionuara me ligjet specifike, me qëllim që kësaj kategorie personash t’u ofrohet shërbimi përkatës i nevojshëm;

- drejtuesit e autobusëve duhet të jenë të pajisur me dokumentin e kualifikimit (certifikatën e aftësisë profesionale) dhe vazhdimisht duhet të kenë me vete dhe të afishuar në një vend të dukshëm të autobusit, numrat e telefonave të emergjencave civile (Policia e Shtetit, urgjenca mjekësore, shërbimi zjarrfikës etj.);

- të evitojnë diskutimet me udhëtarët, duke mbajtur gjithmonë një qëndrim korrekt.”

7. Mbas pikës 19 shtohet pika 19/1, me përmbajtje si më poshtë:

“19/1. Autobusët që kryejnë shërbimet e transportit të rastit/turistik, ndërkombëtar dhe brenda vendit, duhet të kenë një tabelë në pjesën e sipërme të xhamit të përparmë (në krahun e djathtë të drejtuesit të mjetit), në të cilën, me shkronja kapitale të shkruhet “SHËRBIME TË RASTIT”, ku lloji i germës *Impact*, lartësi shkrimi 9 cm. Tabela do të jenë me sfond të verdhë, shkrim të zi dhe dimensione 50 x 25 cm.

8. Pikat 1 dhe 2, kapitulli VI, “Të tjera”, ndryshojnë si më poshtë vijon:

1. Tarifat për kontrollin teknik të mjeteve të transportit publik të udhëtarëve, në zbatim të këtij udhëzimi, janë të përcaktuara në udhëzimin nr. 4, datë 2.8.2013, “Për miratimin e tarifave të kontrollit



teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre.

2. Tarifat e transportit ndërqytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve me autobus janë ato të miratuara me VKM-në nr. 66, datë 7.2.2007, “Për ndryshimin e tarifave të udhëtarëve”, të ndryshuar, ndërsa tarifa e llojit të biletës në transportin qytetas të udhëtarëve me autobus miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, në përputhje me nivelin e standardit të kërkuar për këtë shërbim.”.

9. Togfjalëshi “ministri i Punëve Publike dhe Transportit” zëvendësohet me togfjalëshin “ministri përgjegjës për transportin”, si dhe fjala “shofer” zëvendësohet me fjalën “drejtues mjeti”, kudo ku është përdorur në këtë udhëzim.

10. Në anekset 1 dhe 2 “Aktvlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit, të autobusëve në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe atij brenda vendit”, shtohet lista e elementeve që kontrollohen në autobusë për efekt të komoditetit dhe sigurisë së udhëtimit, si pjesë përbërëse e aktivlerësimit. Kjo listë i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

11. Efektet për plotësimin e kushteve higjieno-sanitare sipas fjalisë së tretë në paragrafin e parë të pikës 5, fillojnë 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto**



KONTROLLI I KOMODITETIT DHE SIGURISË SË UDHËTIMIT NË AUTOBUSAT E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Subjekti _____ Targa _____ Modeli _____

1 ELEMENTET E SIGURISË

a) Dyert	Gjendja Fizike		Gjendja Funksionale		Komandimi /kontrolli Automatik		Vizualiteti nga Drejtuesi		Mundësi hapje nga Udhëtarët	
	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo
<i>Dera e drejtuesit të mjetit</i>	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
<i>Derë udhëtarit</i>	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
<i>Derë udhëtarit</i>	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
<i>Derë/Dritare Emergjence</i>	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐

b) Elementet e emergjencës	Prezent		Funksional		Nëse "JO" shënime të detajuara
	Po	Jo	Po	Jo	
<i>Rrip sigurimi në çdo ndenjësë</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Kuti të ndihmës së shpejtë shëndetsore</i>	☐	☐	☐	☐	
c) Pajisjet Kundër Zjarrit	Prezenca Fizike		Funksionale		Nëse "JO" shënime të detajuara
	Po	Jo	Po	Jo	
<i>Fikse zjarri</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Çekiç për thyerje xhamash</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Të Tjera sipas manualit</i>	☐	☐	☐	☐	
1 _____	☐	☐	☐	☐	
2 _____	☐	☐	☐	☐	
3 _____	☐	☐	☐	☐	

d) Elemente faktor të rrezikshëm	Prezenca Fizike		Nëse "PO" shënime të detajuara
	Po	Jo	
<i>Dëmtime në dysbeme</i>	☐	☐	
<i>Elemente rrëshqitës</i>	☐	☐	
<i>Tuba mbështetës për udhëtarët</i>	☐	☐	
<i>Tehe të mprehtë</i>	☐	☐	
<i>Koridore të xhveshura</i>	☐	☐	
<i>Sedilje të xhveshura</i>	☐	☐	
<i>Ndryshime të brendëshme konstruktive nga tipi autobuzi</i>	☐	☐	

e) Pajisjet për udhëtim në kushte bore apo ngrice	Prezenca Fizike		Funksionale		Nëse "JO" shënime të detajuara
	Po	Jo	Po	Jo	
<i>Zinxhirë debore</i>	☐	☐	☐	☐	
f) Pajisjet për sigurinë e parkimit në kushtet e difekteve në rrugë	Prezenca Fizike		Funksionale		Nëse "JO" shënime të detajuara
	Po	Jo	Po	Jo	
<i>Trekëndësh bllokimi rruge</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Ndriçues portativ</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Gomë rezervë</i>	☐	☐	☐	☐	



2 ELEMENTET E KOMODITETIT

a) Komoditeti i ndenjësve	Prezenca Fizike		Funksionale		Nëse "JO" shënime të detajuara
	Po	Jo	Po	Jo	
<i>Sistem amortizimi</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Sistem pozicionimi</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Veshje e përshtatshme</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Paisje bllokuese</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Vende për bagazhe të lehta</i>	☐	☐	☐	☐	
b) Veshjet e brendëshme	Hermetike		Nëse "JO" shënime të detajuara		
	Po	Jo			
<i>Veshje në tavan</i>	☐	☐			
<i>Veshje në dyshe</i>	☐	☐			
<i>Veshje në paritet anësore</i>	☐	☐			
c) Dritaret	Prezenca Fizike		Nëse "JO" shënime të detajuara		
	Po	Jo			
<i>Xhama origjinale</i>	☐	☐			
<i>Korniza gome</i>	☐	☐			
<i>Mbrojtje nga dielli</i>	☐	☐			
d) Sistemi i informimit, ndriçimit dhe i kondicionimit të brendshëm	Prezenca Fizike		Funksionale		Nëse "JO" shënime të detajuara
	Po	Jo	Po	Jo	
<i>Të korridoreve</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Në hyrje dhe dalje</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Mbi ndenjësve</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Sistem kondicionimi</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Sistem ngrohje</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Sistem ventilimi</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Qëndër zëri</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Informacioni Hyrje dhe Dalje (Tr. Qytetas)</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Numri i ndenjësve dhe kapacitet Max (Tr. Qytetas)</i>	☐	☐	☐	☐	
e) Kushte specifike higjieno sanitare (Transporti Ndërkombëtar)	Prezenca Fizike		Nëse "JO" shënime të detajuara		
	Po	Jo			
<i>Set WC</i>	☐	☐			
<i>Lavaman i vogël</i>	☐	☐			
<i>Kushte sanitare (ujë, sapun...higjienizues)</i>	☐	☐			
f) Elementet e estetikës së jashtme	Deformime apo shtypje		Gërvishje apo niolla		Nëse "PO" shënime të detajuara
	Po	Jo	Po	Jo	
<i>Sipërfaqja e jashtme e autobusit</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Uniformiteti i lërjes së jashtme e kabinës sipas</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Lejes së Qarkullimit</i>	☐	☐	☐	☐	
g) Elementet e Informacionit	Prezente		Përmasa të pranueshme		Shënime të detajuara
	Po	Jo	Po	Jo	
<i>Emërtimi i shoqërisë/ subjektit transportues</i>	☐	☐	☐	☐	
<i>Informacione të karakterit tregtar</i>	☐	☐	☐	☐	

KOMISIONI

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

KRYETARI

(emri, mbiemri, firma)

Lëshuar më ____/____/____; i vlefshëm deri më ____/____/____



UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 3946, datë 10.6.2016

PËR MBLEDHJEN DHE RUAJTJEN E TË DHËNAVE PËR CILËSINË E LËNDËVE DJEGËSE TË LËNGËTA TË MESME TË RËNDA (GAS OIL), LËNDËVE DJEGËSE TË LËNGËTA TË RËNDA (HEAVY FUEL OIL) DHE LËNDËVE DJEGËSE TË LËNGËTA MARINË (MARINE FUEL)

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 8, të vendimit nr. 781, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, ministri i Energjisë dhe Industrisë, ministri i Mjedisit dhe ministri i Financave,

UDHËZOJNË:

1. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave, bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimtarinë nëpërmjet strukturave të specializuara të tyre për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse, lëndë djegëse të lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*), lëndë djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*) dhe lëndë djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*), sipas standardeve dhe afateve kohore të përcaktuara në vendimin nr. 781, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”.

2. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD) merr dhe sistemon të dhënat nga prodhuesit vendas dhe nga tregtuesit me shumicë dhe pakicë në lidhje me cilësinë dhe sasinë e lëndëve djegëse të lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*), lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*) dhe lëndëve djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*) për shkallën e përputhshmërisë për secilin parametër fiziko-kimik me ato në përputhje me specifikimet standarde. Një kopje e këtyre të dhënave dërgohet nga ISHTI-ja çdo 6 muaj pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM).

3. Strukturat rajonale të ISHTI-së organizojnë, në bashkëpunim me strukturat rajonale të AKM-së, si dhe me DPD-në, programe pune të përbashkëta për marrjen e mostrave për cilësinë e lëndëve djegëse, të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*) dhe lëndëve djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*).

4. Strukturat përgjegjëse për aktivitetin e tregtimit, të mbledhjes dhe të analizimit të të dhënave të hidrokarbureve dhe të nënprodukteve të tyre në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Ministrinë e Financave, organizojnë 2 herë në vit takime të përbashkëta të institucioneve të vartësisë të ngarkuara për zbatimin e këtij udhëzimi, për shkëmbimin e informacionit mbi ecurinë e zbatimit të vendimit nr. 781, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”. Konkluzionet e takimeve u raportohen ministrave përkatës.

5. Të dhënat e grumbulluara, për parametrat e lëndëve të lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*), lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*) dhe lëndëve djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*), analizohen nga ISHTI-ja dhe janë objekt i diskutimit në takimet e përbashkëta ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Financave sipas pikës 4 të këtij udhëzimi.

6. Rafineritë dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë, pavarësisht detyrimeve të tjera për dërgim informacioni në institucionet shtetërore, dërgojnë pranë Inspektoratit Qendror Teknik, çdo tre muaj, informacion në lidhje me sasinë e lëndëve djegëse, të lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*), lëndë djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*) dhe lëndë djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*), të hedhura në tregun e brendshëm.

7. AKM-ja ruan dhe administron informacionin e marrë nga ISHTI-ja dhe krijon regjistrin e të dhënave në lidhje me sasinë dhe cilësinë e lëndëve djegëse, në përputhje me specifikimet e standardeve të secilit produkt. Një kopje e informacionit publikohet në faqen elektronike të Ministrisë së Mjedisit dhe të AKM-së.



8. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen ISHTI-ja, AKM-ja dhe DPD-ja, si dhe strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Ministrinë e Financave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
Damian Gjikhuri

MINISTRI I FINANCEVE
Arben Ahmetaj

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka

VENDIM

Nr. 74, datë 6.7.2016

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN “MBI PROCEDURAT E NDËRHRYJES SË BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM TË KËMBIMEVE VALUTORE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 2, të nenit 43, shkronja “c” dhe të nenit 61, shkronja “a”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 16.1.2012, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Titulli i nenit 7 ndryshon nga: “Ndërhyrja për rritjen e rezervës valutore”, në: “Ndërhyrja për ndryshimin e rezervës valutore”.

b) Në nenin 7, togfjalëshi: “programin monetar të miratuar”, ndryshon në: “kriteret e mjaftueshmërisë së rezervës valutore të miratuar”.

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare, Departamenti i Operacioneve Monetare dhe Komiteti për Zbatimin dhe Këshillimin e Politikës Monetare.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin në Buletinën Zyrtar dhe në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.8.2016.

KRYETARI
Gent Sejko

VENDIM

Nr. 75, datë 6.7.2016

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN “MBI MINIMUMIN E REZERVËS SË DETYRUAR MBAJTUR NË BANKËN E SHQIPËRISË NGA BANKAT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 19 dhe nenit 43, shkronjat “a” dhe “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 16.5.2012, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 12/1, përmbajtja e pikës 2 ndryshon si më poshtë:

“Teprica e llogarisë rezervë në euro është diferenca e gjendjes në llogarinë rezervë me rezervën e detyruar, e llogaritur çdo ditë”.

b) Në nenin 12/1, pas pikës 2 shtohet pika 2/a me përmbajtje si më poshtë:

“Teprica e llogarisë rezervë në dollarë amerikanë është diferenca e gjendjes në llogarinë rezervë me rezervën e detyruar, e llogaritur çdo ditë, por jo më e vogël se niveli minimal i tepricës”.

c) Në nenin 12/1, pika 3 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“Banka e Shqipërisë remuneron tepricën në euro në gjithë shumën e saj. Banka e Shqipërisë remuneron tepricat në llogaritë rezervë në lekë dhe në dollarë amerikanë vetëm në rastet kur tejkalohet niveli minimal i saj, ku si i tillë konsiderohet shuma për të cilën bankat nuk remunerohen. Si nivel minimal për rezervën e detyruar në lekë dhe USD



konsiderohen përkatësisht shumat 50 milionë lekë dhe 500,000.00 USD”.

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin në Buletin Zyrtar dhe në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 26.9.2016.

KRYETARI
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 80, datë 6.7.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “MBI RAPORTIMET NË
BANKËN E SHQIPËRISË SIPAS
SISTEMIT RAPORTUES TË UNIFIKUAR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” nenit 43, shkronja “c”, nenit 27, nenit 58, nenit 70, pika 1 dhe nenit 71, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 47, pika 4, dhe nenit 126, pika 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, neneve 43, pika 3, dhe 62, pika 1, shkronja “c” dhe neni 72, pika 5, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit të unifikuar të raportimit” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 45, datë 10.6.2009, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 2, pika 3 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“3. nenit 43, pika 3, nenit 62, pika 1, shkronja “c” dhe nenit 72, pika 5, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”.”

b) Në nenin 2, pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtjen e mëposhtme:

“6) neneve 14 dhe 15, të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004, “Për statistikën zyrtare”, i ndryshuar”.

c) Në nenin 3, pas pikës 6 shtohet pika 7 me përmbajtjen e mëposhtme:

“ERRS” është sistemi elektronik raportues rregullator i cili, në zbatim të përgjegjësiave ligjore të Bankës së Shqipërisë dhe kërkesave të kuadrit rregullativ mundëson raportimin “online” të SRU-së dhe të të dhënave të tjera, nga ana e subjekteve raportuese.”

d) Në nenin 5, pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen e mëposhtme:

“3. Formularët shoqërohen nga udhëzuesit dhe manualët përkatës.”

e) Në nenin 6, pika 1, shkronja “d” togfjalëshi “Departamenti i Statistikave” zëvendësohet me togfjalëshin “Departamenti i Statistikave Financiare”.

f) Në nenin 9, pika 1 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“1. Të gjitha sistemet raportuese administrohen nga Zyra e Përpunimit të të Dhënave pranë Departamentit të Statistikave Financiare.”

g) Në nenin 9, pika 2 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“2. Procedurat e punës për administrimin dhe kontrollin e raportimeve përcaktohen me udhëzimet dhe manualët përkatës, të cilat miratohen nga administratori, i cili ka në varësi Departamentin e Statistikave Financiare.”

h) Në nenin 11, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 dhe pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtjen e mëposhtme:

“2/1. Raportimi në formë elektronike për subjektet raportuese banka bëhet përmes ERRS-së.”

“6. Subjektet raportuese të cilat raportojnë përmes sistemit ERRS, dërgojnë me shkrim pranë njësisë pritëse, listën e punonjësve të autorizuar për plotësimin, kontrollin dhe dërgimin e raportimeve. Ndryshimet në listën e punonjësve të autorizuar për raportim duhet të njoftohen pranë njësisë pritëse pranë Bankës së Shqipërisë.”

i) Formularët 20–21, 24, 25, 34, 35, 36, 38/1, 31.1, 20/1, 46, 47, 33A, 33B, F1, F2, F3, F4 bashkëlidhur kësaj rregulloreje shfuqizohen dhe zëvendësohen me formularët F20-21, F37/4, F37/6, F37/5, F37/7, F37.9, F37.8, F37/3, F37/2, F37/1, F37, F34, F34.2, F35, F36.1, F36.2, F8.1, F8.2, F8.3, F8.4, F20_21 Pkon_Valutor, F61.2, F100/1, F60.1, F.33A, F.33B, F1, F2, F3, F4, bashkëlidhur këtij vendimi.

j) të miratojë formularët f22_1, f28, f29, f31.1, f33b1, f33b3, f34.1 f35.2, f4.dm, f8.dm, f7.dm, f11.dm, f12.dm, mkr_sa_tdi, mkr_sa_equ, f3.dm,



f5.dm, f6.dm, f9.dm, f44, f45, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 tetor 2016.

KRYETARI
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 81, datë 6.7.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KONTROLLIN PËR
AUTENTICITET DHE KRITERET E
RICIKLIMIT TË MONEDHAVE
METALIKE SHQIPTARE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c” dhe kreut V, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për kontrollin për autenticitet dhe kriteret e riciklimit të monedhave metalike shqiptare”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Gent Sejko

RREGULLORE

PËR KONTROLLIN PËR AUTENTICITET
DHE KRITERET E RICIKLIMIT TË
MONEDHAVE METALIKE SHQIPTARE

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve për kontrollin për autenticitet, vlerësimin e përshtatshmërisë për qarkullim dhe riciklimin e monedhave metalike lek.

Neni 2

Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c” dhe kreut V, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet “ligji për bankat”.

Neni 3

Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë, si dhe klientët e tjerë me status të veçantë që kryejnë veprime në *cash* me Bankën e Shqipërisë.

Neni 4

Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) “Riciklimi i monedhave metalike” është procesi (veprimi) i ri i hedhjes në qarkullim të monedhave metalike lek, të arkëtuara dhe përpunuara nga subjektet e kësaj rregulloreje gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre;

b) “Makina të përpunimit të monedhave metalike” janë makinat që përdoren nga klientë ose anëtarë stafi të subjekteve të kësaj rregulloreje të cilat në mënyrë të pavarur (automatike) identifikojnë dhe veçojnë fizikisht pa ndërhyrjen e faktorit njeri (operatorit), monedhat metalike të



dyshuara si të falsifikuara dhe/ose të papërshtatshme për qarkullim nga monedhat metalike të vërteta dhe të përshtatshme për qarkullim;

c) “Përpunim i monedhave metalike” është kontrolli i sasisë, autenticitetit dhe përshtatshmërisë për qarkullim i monedhave metalike, kryer nga subjektet e kësaj rregulloreje me anë të makinave të përpunimit të monedhave metalike ose manualisht nga një anëtar i trajnuar i stafit;

d) “Përpunim i automatizuar i monedhave” është përpunimi i monedhave metalike me anë të makinave të përpunimit të monedhave metalike;

e) “Autentifikim” është procesi i verifikimit të monedhave metalike me qëllim veçimin e monedhave metalike të dyshuara të falsifikuara;

f) “Përpunim manual i monedhave metalike” vlerësimi vizual i monedhave metalike nga anëtarë të trajnuar të stafit për përcaktimin e autenticitetit dhe përshtatshmërisë për qarkullim;

g) “Kontrolli për përshtatshmëri i monedhave metalike” është procesi i verifikimit të monedhave metalike, me qëllim veçimin e monedhave metalike të përshtatshme për qarkullim nga ato të papërshtatshme sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore;

h) “Test i performancës së makinerive” është procesi i testimit, sipas procedurave të miratuara nga Banka e Shqipërisë, i sistemeve të brendshme të identifikimit dhe aftësisë së makinës për zhvillimin e funksioneve kryesore të saj;

i) “Anëtarë stafi të trajnuar” janë punonjësit e subjekteve të kësaj rregulloreje të trajnuar nga Banka e Shqipërisë ose nga trajnerë të subjekteve të trajnuar në Bankën e Shqipërisë për kryerjen e autentifikimit të monedhave metalike.

j) “Klientë me status të veçantë” janë personat të cilët kanë fituar statusin e klientit të Bankës së Shqipërisë nëpërmjet një ligji ose marrëveshjeje të veçantë dhe mund të kryejnë veprime në *cash* në Bankën e Shqipërisë.

KREU II

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR RIKIKLINIMIN E MONEDHAVE METALIKE

Neni 5

Kontrolli për autenticitet dhe përshtatshmëri i monedhave metalike lek

1. Subjektet e kësaj rregulloreje hartojnë rregullat dhe procedurat e tyre të brendshme për

përpunimin e monedhave metalike.

2. Subjektet e kësaj rregulloreje, sigurojnë që monedhat metalike lek që arkëtojnë gjatë veprimtarisë së tyre dhe që kanë për qëllim t'i hedhin përsëri në qarkullim, të kontrollohen për autenticitet dhe përshtatshmëri për qarkullim sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

Kontrolli i autenticitetit dhe përshtatshmërisë të monedhave metalike lek kryhet:

a) nëpërmjet makinave të përpunimit të monedhave metalike të testuara me sukses paraprakisht nga Banka e Shqipërisë; ose

b) në mënyrë manuale nga një anëtar stafi i trajnuar për këtë qëllim.

Neni 6

Identifikimi i monedhave metalike lek të dyshuara si të falsifikuara

1. Përpunimi i monedhave metalike siguron që të gjitha monedhat metalike të dyshimta të identifikohen në kohë dhe të mos riciklohen te konsumatorët.

2. Subjektet e kësaj rregulloreje trajtojnë monedhat metalike të veçuara si të dyshuara sipas kuadrit rregullator përkatës për monedhat e dyshuara si të falsifikuara.

Neni 7

Identifikimi i monedhave metalike lek të papërshtatshme

1. Përpunimi i monedhave metalike duhet të garantojë që monedhat metalike të përshtatshme për qarkullim të veçohen nga të papërshtatshmet, në mënyrë që gjendja e monedhave metalike në qarkullim të mbahet në nivele të kënaqshme.

Kontrolli i përshtatshmërisë së monedhave metalike kryhet si më poshtë:

a) monedhat metalike të përpunuara automatikisht, të veçuara nga makina e përpunimit të monedhave metalike si të dyshuara, por të rezultuara autentike do të veçohen si monedha metalike të papërshtatshme për qarkullim;

b) monedhat metalike të përpunuara manualisht, të cilat kanë pësuar ndryshime në pamjen ose formën e tyre për shkak të tjetërsimit të veçorive fizike si pasojë e qarkullimit, korrozionit, ose dëmtimit nga ndikimi i faktorëve të ndryshëm fizikë do të veçohen si të papërshtatshme për qarkullim.



2. Monedhat metalike lek të veçuara si të papërshtatshme për qarkullim gjatë procesit të përpunimit, dërgohen në Bankën e Shqipërisë.

KREU III MAKINAT E PËRPUNIMIT TË MONEDHAVE METALIKE

Neni 8

Kërkesa të përgjithshme teknike

1. Makinat e përpunimit të monedhave metalike duhet të përpunojnë monedhat metalike lek, duke klasifikuar dhe veçuar fizikisht monedhat metalike të përshtatshme për qarkullim nga ato të dyshuara të falsifikuara dhe/ose të papërshtatshme për qarkullim pa ndërhyrjen e faktorit njeri (operatorit).

2. Makinat e përpunimit të monedhave metalike duhet të përshtaten për të siguruar identifikimin me saktësi dhe veçimin e monedhave metalike të falsifikuara të reja.

Neni 9

Kategoritë e makinave të përpunimit të monedhave metalike

1. Makinat e përpunimit të monedhave metalike kategorizohen në makina të përdorura nga klienti ose makina të përdorura nga stafi.

2. Makinat e përpunimit të monedhave metalike të përdorura nga klientë duhet të sigurojnë që krahas identifikimit të monedhave metalike të dyshuara si të falsifikuara, të identifikojnë edhe klientin përdorues të makinës.

Neni 10

Teste për kontrollin e performancës së makinave

1. Subjektet e kësaj rregulloreje për përpunimin e automatizuar të monedhave metalike mund të përdorin vetëm makina, performanca e të cilave është testuar me sukses nga Banka e Shqipërisë.

2. Testet e performancës së makinave duhet të përfshijnë, në varësi të llojit të makinës, një verifikim të performancës së makinës në kontrollin e monedhave metalike për sasi dhe autenticitet.

3. Testet e performancës së makinave zhvillohen bazuar në procedurën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë dhe kanë për qëllim kontrollin e sistemeve të brendshme të identifikimit dhe aftësinë e makinës për zhvillimin e funksioneve kryesore si më poshtë:

a) njohja e monedhave metalike lek;

b) identifikimi dhe veçimi i monedhave metalike lek të dyshuara si të falsifikuara dhe të papërshtatshme për qarkullim; dhe

c) sigurimi i të dhënave të nevojshme për identifikimin e individëve dhe subjekteve poseduese të monedhave metalike lek të dyshuara si të falsifikuara, në qoftë se është i zbatueshëm për llojin e makinës që kontrollohet.

4. Banka e Shqipërisë, për testimin e performancës së çdo tipi makine përdor monedha metalike të falsifikuara të identifikuar gjatë procesit të përpunimit të monedhave të hedhura në qarkullim dhe monedha metalike autentike të përshtatshme dhe të papërshtatshme.

5. Testimi për identifikimin e monedhave të falsifikuara kryhet vetëm me llojet e monedhave metalike të falsifikuara të identifikuar në qarkullim dhe që janë në dispozicion të Bankës së Shqipërisë.

6. Banka e Shqipërisë nuk mban përgjegjësi në qoftë se makina dështon t'u përmbahet kërkesave të kësaj rregulloreje, pavarësisht faktit që lloji i makinës në fjalë është testuar me sukses.

7. Banka e Shqipërisë kryen testin e performancës për një lloj makine bazuar në aplikimin e bërë nga prodhuesi i makinës ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij.

8. Prodhuesi i makinës ose personi i autorizuar prej tij, dorëzon aplikimin pranë Bankës së Shqipërisë së bashku me të gjithë dokumentacionin dhe informacionin përkatës mbi funksionimin e makinës. Banka e Shqipërisë do ta trajtojë këtë informacion si konfidencial.

9. Në rastin kur testi i performancës rezulton i suksesshëm, Banka e Shqipërisë lëshon raportin përkatës. Raporti i lëshuar nga Banka e Shqipërisë është i vlefshëm për një periudhë 2-vjeçare, në përfundim të së cilës performanca e makinës duhet të rritetohet përsëri.

10. Banka e Shqipërisë publikon në faqen e saj të internetit një listë të llojeve të makinave, të cilat kanë kaluar me sukses testet e performancës.

11. Për çdo përmirësim ose përditësim të *hardware/software*-it në makinat që kanë kaluar me sukses testet e performancës, prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar ka detyrimin të aplikojë për rritimin e performancës së këtyre makinave.



Neni 11

Përdorimi i makinave nga subjektet e kësaj rregulloreje

1. Subjektet e kësaj rregulloreje, për përpunimin automatik të monedhave metalike lek, mund të përdorin llojet e makinerive që përfshihen në listën e publikuar në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë.

2. Subjektet e kësaj rregulloreje njoftojnë Bankën e Shqipërisë mbi instalimin e një makine të përpunimit të monedhave metalike, përpara se makina të vihet në punë.

3. Subjektet e kësaj rregulloreje duhet të marrin një konfirmim zyrtar nga prodhuesi i makinës ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, që garanton se karakteristikat e makinës së instaluar korrespondojnë me ato të makinës, të përfshirë në listën e publikuar në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë dhe që makina e instaluar përpunon monedha metalike në të njëjtën mënyrë si makina e të njëjtut lloj të testuar nga Banka e Shqipërisë. Subjektet duhet të dorëzojnë në Bankën e Shqipërisë deklarinimin së bashku me njoftimin e instalimit të makinës.

KREU IV

**RAPORTIMI DHE MBIKËQYRJA
(INSPEKTIMI)**

Neni 12

Monitorimi

1. Me marrjen e njoftimit për instalimin e makinerisë, Banka e Shqipërisë mund të kryejë një kontroll të hartimit dhe zbatimit të procedurave për përpunimin e monedhave metalike dhe mund të kryejë testet e performancës së makinave të instaluar, në mënyrë që të përcaktojë nëse këto makina kontrollojnë monedhat në mënyrë të besueshme mbi autenticitetin dhe përshtatshmërinë për qarkullim dhe lejojnë ndjekjen/regjistrimin e transaksioneve në rastet e përdorimit nga klientët.

2. Departamenti i Emisionit pranë Bankës së Shqipërisë, realizon verifikimin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje nëpërmjet:

a) kryerjes së inspektimeve në vend, përfshirë këtu dhe inspektimet e panjoftuara, në vëndndodhjet e subjekteve, për të monitoruar makinat e tyre të përpunimit të monedhave metalike; dhe

b) verifikimit të procedurave që rregullojnë operimin dhe kontrollin e makinave të përpunimit të *cash*-it, trajtimin e monedhave metalike lek të kontrolluara dhe procedurat që rregullojnë çdo kontroll manual të autenticitetit dhe përshtatshmërisë.

3. Banka e Shqipërisë, për verifikimin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje gjatë procesit të inspektimit në mjediset e subjekteve, mund të marrë kampione të monedhave metalike të përpunuara për t'i kontrolluar ato në ambientet e saj.

4. Në rast konstatimi të moszbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë rekomandon për subjektet marrjen e masave korrigjuese brenda një afati kohor të caktuar.

Neni 13

Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14

Dispozitë kalimtare

1. Subjektet e kësaj rregulloreje janë të detyruara të plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të saj.

2. Pavarësisht pikës 1 të këtij neni, makinat e përpunimit të monedhave metalike të instaluar përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të përshtaten për kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, jo më vonë se 12 muaj nga hyrja në fuqi e saj.

Neni 15

Të tjera

1. Banka e Shqipërisë trajton informacionin e marrë sipas kësaj rregulloreje si konfidencial.

2. Banka e Shqipërisë do të publikojë, në faqen e saj zyrtare të internetit, procedurat teknike për testet e performancës së makinave dhe formularin e aplikimit.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

**VENDIM****Nr. 106, datë 29.6.2016****PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI
NË “RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR
TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16; 81, pika 2; 99 dhe 110, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; nenit 26 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s dhe vendimit nr. 102, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a., lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me miratimin e një ndryshimi në “Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në “Rregullat e tregut”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, i ndryshuar, si më poshtë:

Në kapitullin IX. 1.3, germa “g”, bëhet si më poshtë:

g.1 “Duke filluar nga 1 korriku 2016, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike, me përjashtim të subjekteve të përcaktuara në ligjin nr. 138/2013, “Për burimet e rinovueshme dhe sipas pikës 4, të nenit 99, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike.”.

g.2 Klientët fundorë, që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal, nuk janë përgjegjës për disbalancat kundrejt këtij të fundit.

2. KESH sh.a. duke qenë sigurues i shërbimeve ndihmëse dhe balancimit, nuk do të jetë subjekt i disbalancave për periudhën e mbetur të vitit 2016.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 107, datë 29.6.2016****MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “BALKAN GREEN
ENERGY” SHPK ME NR. 3, SERIA.PVO3K,
DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE NR. 69,
DATË 12.12.2007**

Në mbështetje të neneve 16, 43, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM-së nr. 930, datë 2.9.2009, “Për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen shtesë të koncesionit për 25 hidrocentralet vendore, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë italiane “Essegi” s.p.a., miratuar me vendimin nr. 148, datë 22.3.2007, të Këshillit të Ministrave, nenit 15 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, miratuar me vendimin nr. dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve, për modifikimin e licencës së shoqërisë “Balkan Green Energy”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Favina” sh.p.k. në cilësinë e pronarit të HEC “Voskopojë” i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 100 prot., datë 21.1.2016, duke kërkuar rritjen e fuqisë së instaluar të këtij HEC-i.

- ERE pas verifikimeve të bëra, konstaton së mbështetur në vendimin nr. 69, datë 12.12.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është shoqëria koncesionare “Balkan Green Energy” sh.p.k., e licencuar për të ushtruar aktivitetin e



prodhimit nga HEC “Voskopoja”.

- ERE, me shkresën nr. 101/1 prot., datë 20.4.2016, i është drejtuar MEI-t, në lidhje me saktësimin e pronësisë së HEC “Voskopojë”.

- MEI është përgjigjur me shkresën nr. 2810/1, datë 23.5.2016, përmes së cilës i ka kërkuar ERE-s, zbatimin e marrëveshjes së koncesionit në përputhje me VKM-në nr. 930, datë 2.9.2009.

- VKM-në nr. 930, datë 2.9.2009, “Për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen shtesë të koncesionit për 25 hidrocentralet vendore, të lidhur, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë italiane “Essegei” s.p.a., miratuar me vendimin nr. 148, datë 22.3.2007, të Këshillit të Ministrave ka hequr nga lista e HEC-eve për të cilat është licencuar shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k. HEC-et: “Piqeras”, “Lozhan” dhe “Voskopojë”, në zbatim të nenit 5, i cili përcakton se: “Trajtimi i hidrocentraleve Piqeras, Lozhan dhe Voskopojë, do të merren në dorëzim dhe do të trajtohen nga Organi Shtetëror i Autorizuar”.

- Neni 43, pika 1, e ligjit nr. 43/2015, parashikon se: ERE mund të modifikojë licencën, me iniciativën e vet, kur ndryshojnë kushtet e kontratës koncesionare.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës me numër nr. 3, seria PV03K, dhënë shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k., me vendim të Bordit të ERE-s nr. 69, datë 12.12.2007, në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 930, datë 2.9.2009.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 108, datë 29.6.2016

MBI KËRKESËN E SHOQATËS SHQIPTARE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME PËR RISHIKIMIN/PEZULLIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 77, DATË 7.6.2016, “PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 16, pika 4 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.6.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrotjtjes së Konsumentit, mbi kërkesën e shoqatës shqiptare të energjisë së rinovueshme “AREA”, për rishikimin/pezullimin e vendimit nr. 77, datë 7.6.2016, të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Në nenin 108, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se “Ngarkohet ERE që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji... të miratojë me propozimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, rregullat e tregut të energjisë elektrike.”

- Nuk është paraqitur asnjë provë e re, për të mbështetur kërkesën për rishikim/pezullimin e procedurave të miratimit të “Rregullave të tregut.”

- Shoqata “AREA” nuk përfaqëson palë interes, të legjitimuar për të kërkuar rishikimin e një vendimi të Bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqatës shqiptare të energjisë së rinovueshme “AREA”, për rishikimin/pezullimin e vendimit nr. 77, datë 7.6.2016, të Bordit të ERE-s, “Për fillimin e procedurave për miratimin e rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”.



2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë AREA-n, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 109, datë 29.6.2016

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN, MODIFIKIMIN, TRANSFERIMIN, RINOVIMIN OSE HEQJEN E LICENCAVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 20 dhe 39, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 26, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.6.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” dhe relacionin përkatës,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

2. Të shfuqizojë vendimin nr. 108, datë 9.9.2008, të Bordit të ERE-s.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

RREGULLORJA

PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR
DHËNIEN, MODIFIKIMIN,
TRANSFERIMIN, RINOVIMIN OSE HEQJEN
E LICENCAVE NË SEKTORIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të neneve 20 dhe 39, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe në përputhje me “Rregullat e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”.

Neni 2

Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore përcakton procedurat e licencimit për ushtrimin e aktiviteteve të parashikuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, duke specifikuar rregullat dhe kërkesat për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin e licencave në sektorin e energjisë elektrike.

Neni 3

Përkufizime

Në këto rregulla, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

“Aplikues” është çdo person që aplikon për kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore”.

“Aplikimi” do të thotë dokumentet e parashikuara në nenet 8 dhe 9 të kësaj rregulloreje, të paraqitura të plotësuara në përputhje me këto nene nga një aplikues, si dhe kërkesat dhe dokumentet e paraqitura sipas neneve 11, 15, 16, 17 të kësaj rregulloreje.

“Refuzim i aplikimit” do të thotë vendimi i Bordit të ERE-s i marrë në përputhje me këtë rregullore për moslicencimin, mosrinovimin e licencës, mospranimin e modifikimeve të propozuara apo mospranimin e transferimit të plotë/të pjesshëm të licencës.

“Pranimi i aplikimit” do të thotë vendimi i Bordit të ERE-s i marrë në përputhje me këtë rregullore për licencimin, modifikimin, transferimin, rinovimin e licencave në sektorin e energjisë elektrike.



“Bordi” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, që përbëhet nga pesë anëtarë, të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

“ERE” do të thotë Enti Rregullator i Energjisë, përgjegjës për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjet e cituara më sipër dhe aktet nënligjore në fuqi.

“Licencë” është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e ligjit të cituar më sipër.

“I licencuar” do të thotë një person i pajisur me licencë për aktivitete të energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

“Person” do të thotë çdo person/juridik, që ushtron aktivitet në sektorin e energjisë elektrike.

“I deleguari përgjegjës” do të thotë një person fizik/juridik, që aplikon për një licencë në emër të një aplikuesi sipas nenit 7.

“Drejtnesi kryesor” do të thotë administratori, ose drejtuesi/drejtnesi e nivelit të lartë të personit si dhe drejtuesit kryesorë inxhiniero-teknikë, ekonomikë, juridikë.

Neni 4 Licencat

ERE lëshon licenca për veprimtaritë e mëposhtme:

- a) prodhimin e energjisë elektrike;
- b) operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;
- c) operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike;
- d) furnizimin e energjisë elektrike;
- e) tregtimin e energjisë elektrike;
- f) operimin e tregut të energjisë elektrike;
- g) sistemet e mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike.

2. Nuk jepet licencë për operimin e një linje direkte në transmetim apo shpërndarje, për:

- a) vetëprodhuesit të cilët nuk janë të lidhur me rrjetin kombëtar;
- b) kur lidhja me rrjetin kombëtar bëhet me qëllime të mirëmbajtjes së njësisë së tij të prodhimit;

c) prodhuesit, përfshirë dhe vetëprodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW.

3. Këto subjekte, në çdo rast, janë të detyruar të respektojnë rregullat e tregut dhe kodet e rrjetit.

Neni 5

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës

1. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencave të lëshuara nga ERE për veprimtaritë e parashikuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, përcaktohet nga ERE, brenda kufijve të mëposhtëm:

- a) prodhimin e energjisë elektrike deri në 30 vjet;
- b) operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike deri 30 vjet;
- c) operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, deri në 30 vjet;
- d) furnizimin me energji elektrike, deri në 5 vjet;
- e) tregtimin e energjisë elektrike, deri në 5 vjet;
- f) operimin e tregut të energjisë elektrike, deri në 5 vjet;
- g) sistemet e mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike, deri në 5 vjet.

KAPITULLI II PROCEDURAT E APLIKIMIT

Neni 6

E drejta për të aplikuar për një licencë

Ka të drejtë të aplikojë për një licencë të lëshuar nga ERE, çdo person që ka selinë e tij në Shqipëri, dhe me objekt të veprimtarisë aktivitetin e kërkuar për licencim. Çdo person i huaj duhet të krijojë një shoqëri sipas legjislacionit në fuqi, me objekt veprimtarie aktivitetin e kërkuar për licencim nga ERE për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së licencës.

Neni 7

Delegimi i të drejtave të aplikuesit

1. Aplikuesi mund të caktojë një person fizik ose juridik si të deleguar përgjegjës për të aplikuar për një licencë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me këto procedura licencimi.

2. I deleguari përgjegjës do të paraqesë në ERE:

- a) prokurën e aplikuesit për përfaqësimin e tij;
- b) vërtetim që i deleguari përgjegjës nuk është përfshirë në një proces të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).



3. Detyrat e të deleguarit përgjegjës, janë:

a) të paraqesë aplikimin për një licencë, së bashku me dokumentacionin e kërkuar sipas neneve 8, 9 dhe 11, 15, 16, 17, të kësaj rregulloreje;

b) të paraqesë të dhëna dhe informacion shtesë të kërkuar nga ERE gjatë shqyrtimit të aplikimit për licencë.

Neni 8

Paraqitja e aplikimit

1. Aplikimi konsiston në formatin e aplikimit dhe dokumentacionin që përcaktohet në nenin 9 të kësaj rregullore, të plotësuar nga aplikuesi.

2. Aplikuesi do të kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit, siç përcaktohet në aneksin A të kësaj rregulloreje.

3. Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose fotokopje e noterizuar, ndërsa vërtetimet dhe deklaratat nga organe të tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.

4. Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë

aplikimin në ERE duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes së lejeve nga institucionet e tjera.

5. Dokumentacioni teknik, sipas tipit të licencës, duhet të jetë i hartuar dhe i sigluar nga ekspertë të licencuar (ing. elektrikë, ing. mekanikë, ekspertë kontabël, ing. hidroteknikë etj.).

6. Çdo aplikim i shoqëruar me dokumentacionin përkatës do të paraqitet në dy kopje: një origjinale ose fotokopje e noterizuar dhe një kopje elektronike e të gjithë dokumentacionit, siç përcaktohet nga kjo rregullore.

7. Për centralet të cilat përdorin energjinë valore të detit dhe/ose energjinë e baticave dhe të zaticave paraqiten të njëjtat dokumente të aplikueshme, si për HEC-in dhe në përputhje me kuadrin ligjor.

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

1. Formatin e aplikimit

a) Të dhëna për aplikimin (të plotësohen nga aplikuesi)

Bazuar në ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” kërkoj nga ERE procedimin e këtij aplikimi sipas specifikimit të mëposhtem në tabelë, në bazë të të dhënave të përgjithshme dhe të dhënave teknike të bashkëngjitura këtij aplikimi, në përputhje me kuadrin ligjor në sektorin e energjisë elektrike dhe të rregullores së procedurave të licencimit.	
1	Lloji i aplikimit ☐ Licencim ☐ Modifikim ☐ Transferim ☐ Rinovim
2	Tipi i licencës ☐ Prodhimin e energjisë elektrike ☐ Operimin e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike ☐ Operimin e Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike ☐ Furnizimin e energjisë elektrike ☐ Tregëtimin e energjisë elektrike ☐ Operimin e Tregut të energjisë elektrike ☐ Sistemet e mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike



b) Të dhëna identifikuese të aplikuesit (të plotësohen nga aplikuesi)

1	Emri i subjektit		
	Numri i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit		
2	Selia qendrore	Adresa	
		Cel	
		Tel	
		Fax	
3	Drejtuesi kryesor i subjektit	Emri	
		Funksioni	
4	I deleguari përgjegjës	Emri	
		Adresa	
		Cel	
		Tel	
		Fax	

c) Të dhëna për aplikuesin (të plotësohen nga aplikuesi)

1	Deklaroj se aplikuesit nuk i është hequr apo refuzuar më parë një licencë për operimin në sektorin e energjisë elektrike brenda apo jashtë vendit.	Po ☐	Jo ☐
2	Deklaroj se në cilësinë e aplikuesit jam njohur me kuadrin ligjor, si dhe angazhohem për zbatimin e tij dhe të rregullave dhe rregulloreve të miratuara nga ERE për operimin në sektorin e energjisë elektrike.	Po ☐	Jo ☐
3	Deklaratë e aplikuesit për kryerjen e aktiviteteve të tjera. Nëse po, listoni në kolonën e fundit.	Po ☐	Jo ☐

Shënim. Shënoni me X në kuadratin PO për të konfirmuar.

2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor

a) Akti i themelimit.

b) Statuti.

c) Vërtetim për regjistrimin dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).

d) Vërtetim që personi dhe drejtuesit kryesorë të tij në rastin e personave juridikë nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).

e) Struktura e ndërtimit dhe e funksionimit administrativ të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit (në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca).

f) Marrëveshje koncensionit ose autorizimi nga KM-ja në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës, si dhe ndryshim të këtyre akteve.

g) Dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjekte që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar).

3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

a) Vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj institucionit të Sigurimeve Shoqërore (për shoqëritë e sapokrijuara vërtetim që nuk ka detyrime).

b) Paraqitje bilanci financiar të tri viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit).

c) Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.).



d) Vërtetimin e pagimit në llogari të ERE-s, të pagesës së regjistrimit për aplikim sipas aneksit A të kësaj rregulloreje.

4. Dokumentacioni teknik

4.1 Dokumentacioni teknik për HEC

4.1.1 Të dhëna teknike për HEC (të plotësohen nga aplikuesi)

1	Të dhëna për centralin prodhues	Njësia	
2	Emri		
3	Vendndodhja (numri i regjistrimit të pronës)		
4	Tipi i centralit HEC		Dige ☐ ☐ Derivacion Basen ☐ ☐ Rezerva pompimi
5	Tipi i turbinës		
6	Kapaciteti ujëmbledhës i basenit	m ³	
7	Prurjet mesatare vjetore	l/s	
8	Gjatësia e kanalit të derivacinit	M	
9	Rënia H_{netto}	M	
10	Fuqia e instaluar	MW	
11	Numri i njësive gjeneruese dhe fuqia e instaluar e secilës	Nr. * MW	
12	Tensioni në dalje të gjeneratorit	kV	
13	N/st ku lidhet		
14	Tensioni i rrjetit të shpërndarjes/transmetimit ku lidhet centrali	kV	
15	Prodhimi vjetor i energjisë E_{vjet}	MWh	
16	Rendimenti		
17	Viti i ndërtimit		
18	Data e fillimit të operimit		
19	Jetëgjatësia e pritshme e centralit		

4.1.2 Të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin (të plotësohen nga aplikuesi)

1	Prodhuesi i transformatorit		
2	Kapaciteti	MVA	
3	Tensioni i pësjtjellave	kV	
4	Skema e lidhjes së pësjtjellave		
5	Linja transmetuese		☐ Kablllore ☐ Ajrore
6	Gjatësia e linjës	km	
7	Kapaciteti transmetues	MW	
8	Niveli i tensionit të linjës	kV	
9	Lloji i përcjellësve		
10	Seksioni i përcjellësve	mm ²	



4.1.3 Dokumentacioni teknik dhe grafik

- a) Paraqitjen e përgjithshme skematike të centralit në format A1.
- b) Një diagram elektrik në format A1 të aggregateve dhe bllokut të transformimit, ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes.
- c) Shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadaestre) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1: 25000.
- d) Një hartë topografike ku të paraqitet gjurma e linjës transmetuese në shkallë 1: 25000.

4.1.4 Dokumentacioni tekniko-ekonomik

- a) Studimi i fisibilitetit teknik, bazuar në të dhëna dhe matje reale të kryera në zonat e zbatimit të projekteve, ku të përfshihen: përshkrim i përgjithshëm i projektit, kushtet klimatike dhe meteorologjike për zonën e projektit sipas tipit të centralit; përshkrimi teknik i zgjedhjes së çdo elementi të centralit bazuar në të dhënat e mësipërme; llogaritjet në të cilat bazohen përzgjedhjet e kryera; studimi, llogaritjet dhe përzgjedhjet e pajisjeve për lidhjen me sistemin dhe transmetimin e energjisë; studim dhe analizë e kushteve gjeologjike-inxhinierike të zonës ku zbatohet projekti;
- b) Grafikon e zbatimit të projektit;
- c) Oponencën teknike të projektit;
- d) Plani i biznesit në të cilin të jepen: parashikimi vjetor i kostove, shitjeve, të ardhurat dhe financimi i projektit; investimi i kërkuar për realizimin e projektit (preventivi përfundimtar); detaje të çdo rrjedhe substanciale të pritshme të kapitalit, përfshirë kostot kryesore të dekomisionimit (nxjerrjes jashtë shërbimit); vlerësim i *cash flow* vjetor neto për periudhën e realizimit dhe funksionimit të projektit për të demonstruar sigurinë financiare dhe, fisibilitetin e projektit; informacion në lidhje me burimet e financimit dhe kur është e nevojshme dhe, sipas rastit, konfirmim nga huadhënësit respektivë. Ky dokument duhet të jetë audituar nga një ekspert kontabël i licencuar dhe të përshkruajë periudhën nga fillimi i projektit deri në likuidimin e financimit të kryer për realizimin e projektit;
- e) Miratim i projektit të zbatimit nga organi i caktuar me ligj.

4.1.5 Lejet nga institucione të tjera

- a) Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose të shpërndarjes;
- b) Leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike;
- c) Leje mjedisore nga organet përkatëse.

4.2 Dokumentacioni teknik për TEC

4.2.1 Të dhëna teknike për TEC (të plotësohen nga aplikuesi)

1	Të dhëna për centralin prodhues	Njësia	
2	Emri		
3	Vendndodhja (numri i regjistrimit të pronës)		
4	Tipi i centralit TEC		☐ Lëndë djegëse fosile ☐ Gjeotermale ☐ Biomasa/biogaz ☐ Ngrohja nga proceset industriale të industrisë së rëndë ☐ Grup motor-gjenerator
5	Tipi i turbinës		☐ Turbina avulli



			☐ Turbina gazi ☐ Cikël i kombinuar
6	Lënda djegëse		
7	Konsumi vjetor i lëndës djegëse	t/vit	
8	Konsumi vjetor i ujit për ftohje	t/vit	
9	Prodhimi i avullit	t/vit	
10	Emetimi i CO ₂	mg/m ³	
		t/vit	
11	Emetimi i SO ₂	mg/m ³	
		t/vit	
12	Emetimi i NO _x	mg/m ³	
		t/vit	
13	Emetimi i CO	mg/m ³	
		t/vit	
14	Emetimi i materialeve solide	t/vit	
15	Fuqia e instaluar	MW	
16	Numri i njësjive gjeneruese dhe fuqia e instaluar e secilës	Nr. * MW	
17	Tensioni në dalje të generatorit	kV	
18	N/st ku lidhet		
19	Tensioni i rrjetit të shpërndarjes/transmetimit ku lidhet centrali	kV	
21	Prodhimi vjetor i energjisë E _{vjet}	MWh	
22	Prodhimi vjetor i avullit	t/vit	
23	Rendimenti elektrik		
24	Rendimenti termik		
25	Viti i ndërtimit		
26	Data e fillimit të operimit		
27	Jetëgjatësia e pritshme e centralit		

4.2.2 Të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin (të plotësohen nga aplikuesi)

1	Prodhuksi i transformatorit		
2	Kapaciteti	MVA	
3	Tensioni i përshtjellave	kv	
4	Skema e lidhjes së përshtjellave		
5	Linja transmetuese		☐ Kablllore ☐ Ajrore
6	Gjatësia e linjës	km	
7	Kapaciteti transmetues	MW	
8	Tensioni i linjës	kv	
9	Lloji i përcjellësve		
10	Seksioni i përcjellësve	mm ²	



4.2.3 Dokumentacioni teknik grafik

- a) Paraqitjen e përgjithshme skematike të centralit në format A1.
- b) Një diagram elektrik në format A1 të aggregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes.
- c) Shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo do të zhvillohet veprimtaria duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastrë) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1:25000.
- d) Një hartë topografike ku të paraqitet gjurma e linjës transmetuese në shkallë 1:25000.

4.2.4 Dokumentacioni tekniko-ekonomik

a) Studimi i fisibilitetit teknik, bazuar në të dhëna dhe matje reale të kryera në zonat e zbatimit të projekteve, ku të përfshihen: përshkrim i përgjithshëm i projektit, kushtet klimatike dhe meteorologjike për zonën e projektit sipas tipit të centralit; përshkrimi teknik i zgjedhjes së çdo elementi të centralit bazuar në të dhënat e mësipërme; llogaritjet në të cilat bazohen përzgjedhjet e kryera; studimi, llogaritjet dhe përzgjedhjet e pajisjeve për lidhjen me sistemin dhe transmetimin e energjisë; studim dhe analizë e kushteve gjeologjike-inxhinierike të zonës ku zbatohet projekti; studim dhe analizë e tregjeve dhe mundësive të sigurimit të lëndës djegëse.

b) Grafikon e zbatimit të projektit.

c) Oponencën teknike të projektit.

d) Plani i biznesit në të cilin të jepen: parashikimi vjetor i kostove, shitjeve, të ardhurat dhe financimi i projektit; investimi i kërkuar për realizimin e projektit (preventivi përfundimtar); detaje të çdo rrjedhe substanciale të pritshme të kapitalit, përfshirë kostot kryesore të dekomisionimit (nxjerrjes jashtë shërbimit); vlerësim i *cash flow* vjetor neto për periudhën e realizimit dhe të funksionimit të projektit për të demonstruar sigurinë financiare dhe fisibilitetin e projektit; informacion në lidhje me burimet e financimit dhe kur është e nevojshme dhe sipas rastit, konfirmim nga huadhënësit respektivë. Ky dokument duhet të jetë audituar nga një ekspert kontabël i licencuar dhe të përshkruajë periudhën nga fillimi i projektit deri në likuidimin e financimit të kryer për realizimin e projektit.

4.2.5 Lejet nga institucione të tjera

a) Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose të shpërndarjes;

b) Leja e përdorimit të ujit;

c) Leje mjedisore nga organet përkatëse.

4.3 Dokumentacioni teknik për centralet EOLIKE

4.3.1 Të dhëna teknike për centralet EOLIKE (të plotësohen nga aplikuesi)

1	Të dhëna për centralin prodhues	Njësia	
2	Emri		
3	Vendndodhja (numri i regjistrimit të pronës)		
4	Tipi i centralit		☐ Off shore ☐ On shore
5	Lartësia e kullës	m	
6	Diametri i rotorit	m	
7	Shpejtësia e erës <i>min</i> dhe <i>max</i> e shfrytëzueshme	m/s	
8	Orët e punës në një vit	h	
9	Fuqia e instaluar	MW	
10	Numri i njësive gjeneruese dhe fuqia e instaluar e secilës	Nr * MW	
11	Tensioni në dalje të gjeneratorit	kv	
12	N/st ku lidhet		
13	Tensioni i rrjetit të shpërndarjes/transmetimit ku lidhet centrali	kv	
14	Prodhimi vjetor i energjisë E_{vjet}	MWh	
15	Rendimenti		



16	Viti i ndërtimit		
17	Data e fillimit të operimit		
18	Jetëgjatësia e pritshme e centralit		

4.3.2 Të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin (të plotësohen nga aplikuesi)

1	Prodhuksi i transformatorit		
2	Kapaciteti	MVA	
3	Tensioni i përshtjellave	kv	
4	Skema e lidhjes së përshtjellave		
5	Linja transmetuese		☐ Kabllorë ☐ Ajrore
6	Gjatësia e linjës	km	
7	Kapaciteti transmetues	MW	
8	Tensioni i linjës	kv	
9	Lloji i përcjellësve		
10	Seksioni i përcjellësve	mm ²	

4.3.3 Dokumentacioni teknik-grafik

- Paraqitjen e përgjithshme skematike të centralit në format A1.
- Një diagram elektrik në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes.
- Shtirirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo do të zhvillohet veprimtaria duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastrë) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1:25000.
- Një hartë topografike ku të paraqitet gjurma e linjës transmetuese në shkallë 1: 25000.

4.3.4 Dokumentacioni tekniko-ekonomik

- Studimi i fisibilitetit teknik, bazuar në të dhëna dhe matje reale të kryera në zonat e zbatimit të projekteve, ku të përfshihen: përshkrim i përgjithshëm i projektit, kushtet klimatike dhe meteorologjike për zonën e projektit sipas tipit të centralit; përshkrimi teknik i zgjedhjes së çdo elementi të centralit bazuar në të dhënat e mësipërme; llogaritjet në të cilat bazohen përzgjedhjet e kryera; studimi, llogaritjet dhe përzgjedhjet e pajisjeve për lidhjen me sistemin dhe transmetimin e energjisë; studim dhe analizë e kushteve gjeologjike-inxhinierike të zonës ku zbatohet projekti.

- Grafikun e zbatimit të projektit.

- Oponencën teknike të projektit.

- Plani i biznesit në të cilin të jepen: parashikimi vjetor i kostove, shitjeve, të ardhurat dhe financimi i projektit; investimi i kërkuar për realizimin e projektit (preventivi përfundimtar); detaje të çdo rrjedhe substanciale të pritshme të kapitalit, përfshirë kostot kryesore të dekomisionimit (nxjerrjes jashtë shërbimit); vlerësim i *cash flow* vjetor neto për periudhën e realizimit dhe të funksionimit të projektit për të demonstruar sigurinë financiare dhe fisibilitetin e projektit; informacion në lidhje me burimet e financimit dhe kur është e nevojshme dhe sipas rastit, konfirmim nga huadhënësit respektivë. Ky dokument duhet të jetë audituar nga një ekspert kontabël i licencuar dhe të përshkruajë periudhën nga fillimi i projektit deri në likuidimin e financimit të kryer për realizimin e projektit.

4.3.5 Lejet nga institucione të tjera

- Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes.

- Leje mjedisore nga organet përkatëse.

4.4 Dokumentacioni teknik për centralet SOLARE



4.4.1 Të dhëna teknike për centralet SOLARE (të plotësohen nga aplikuesi)

1	Të dhëna për centralin prodhues	Njësia	
2	Emri		
3	Vendndodhja (numri i regjistrimit të pronës)		
4	Tipi i centralit		☐ Fotovoltaike ☐ Solare termike
5	Tipi i paneleve		☐ Monokristaline ☐ Polikristaline ☐ Jokristalore
6	Sipërfaqja totale e paneleve	m ²	
7	Orët e punës në një vit	H	
8	Fuqia e instaluar	MW	
9	Numri i njësive gjeneruese dhe fuqia e instaluar	Nr * MW	
10	Niveli i tensionit	kv	
11	N/st ku lidhen		
12	Tensioni i rrjetit të shpërndarjes/ transmetimit ku lidhet centrali	kv	
13	Prodhiimi vjetor i energjisë E _{vjet}	MWh	
14	Rendimenti		
15	Viti i ndërtimit		
16	Data e fillimit të operimit		
17	Jetëgjatësia e pritshme e centralit		

4.4.2 Të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin (të plotësohen nga aplikuesi)

1	Prodhuksi i transformatorit		
2	Kapaciteti	MVA	
3	Tensioni i peshtjellave	kv	
4	Skema e lidhjes së peshtjellave		
5	Linja transmetuese		☐ Kablllore ☐ Ajrore
6	Gjatësia e linjës	km	
7	Kapaciteti transmetues	MW	
8	Niveli i tensionit të linjës	kv	
9	Lloji i përcjellësve		
10	Seksioni i përcjellësve	mm ²	

4.4.3 Dokumentacioni teknik-grafik

- Paraqitjen e përgjithshme skematike të centralit në format A1
- Një diagram elektrik në format A1 të aggregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qarte pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes.
- Shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo do të zhvillohet veprimtaria duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadaestre) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1:25000.
- Një hartë topografike ku të paraqitet gjurma e linjës transmetuese në shkallë 1:25000.

4.4.4 Dokumentacioni tekniko-ekonomik

- Studimi i fisibilitetit teknik bazuar në të dhëna dhe matje reale të kryera në zonat e zbatimit të projekteve, ku të përfshihen: përshkrim i përgjithshëm i projektit, kushtet klimatike dhe meteorologjike për zonën e projektit sipas tipit të centralit; përshkrimi teknik i zgjedhjes së çdo elementi të centralit



bazuar në të dhënat e mësipërme; llogaritjet në të cilat bazohen përzgjedhjet e kryera; studimi, llogaritjet dhe përzgjedhjet e pajisjeve për lidhjen me sistemin dhe transmetimin e energjisë; studim dhe analizë e kushteve gjeologjike-inxhinierike të zonës ku zbatohet projekti.

b) Grafikun e zbatimit të projektit.

c) Oponencën teknike të projektit.

d) Plani i biznesit në të cilin të jepen: parashikimi vjetor i kostove, shitjeve, të ardhurat dhe financimi i projektit; investimi i kërkuar për realizimin e projektit (preventivi përfundimtar); detaje të çdo rrjedhe substanciale të pritshme të kapitalit, përfshirë kostot kryesore të dekomisionimit (nxjerrjes jashtë shërbimit); vlerësim i *cash flow* vjetor neto për periudhën e realizimit dhe të funksionimit të projektit për të demonstruar sigurinë financiare dhe fisibilitetin e projektit; informacion në lidhje me burimet e financimit dhe kur është e nevojshme dhe sipas rastit, konfirmim nga huadhënësit respektivë. Ky dokument duhet të jetë audituar nga një ekspert kontabël i licencuar dhe të përshkruajë periudhën nga fillimi i projektit deri në likuidimin e financimit të kryer për realizimin e projektit.

4.4.5 Lejet nga institucione të tjera

a) Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose të shpërndarjes.

b) Leje mjedisore nga organet përkatëse.

4.5 Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike

Të dhëna për linjat e transmetimit

Nr.	Emërtimi i linjës dhe kodi i identifikimit	Kapaciteti transmetues	U _n	I _n	Lloji/seksioni i përcjellësve	Gjatësia	Numri i shtyllave	Numri i qarqeve të linjës	Viti i ndërtimit
		MW	kV	A	mm ²	km			

b) Të dhëna për n/st e sistemit të transmetimit

Nr.	Emri i n/st	Nr. i njërive transformuese	Fuqia e instaluar	U _n	I _n	Skema e lidhjes së përshtjellave	Niveli i rregullimit të tensionit	Tipi i rregullimit të tensionit	Viti i ndërtimit
			MVA	kV	A				

c) Të dhëna për konsumatorët dhe përdoruesit e lidhur në sistemin e transmetimit

Nr.	Emri i përdoruesit / konsumatorit	Fuqia e instaluar	U _n	I _n	Lloji i lidhjes (zbara të n/st, linjë etj.)	Tipi i matjes	Vendndodhja e aparateve matëse
		MW	kV	A			

d) Të dhëna për energjinë që parashikohet të transmetohet

Nr.	Emri i përdoruesit / konsumatorit	Sasia e energjisë				
		GWh				
		Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V

e) Diagrami i sistemit të transmetimit që tregon elementet ekzistuese dhe ato të perspektivës në format A1.

f) Planet e investimeve për përmirësimin mirëmbajtjen dhe zgjerimin e sistemit të transmetimit.

g) Lista e të punësuarve, profesion, formimi.

h) Lista e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

4.6 Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike.

a) Diagrami i sistemit të shpërndarjes që tregon elementet ekzistuese dhe ato të perspektivës.



- b) Planet e investimeve për përmirësimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit shpërndarës.
 c) Planveprimin për uljen e humbjeve teknike dhe joteknike.
 d) Planveprimin për përmirësimin e cilësisë së shërbimit.
 e) Të dhëna për matjen, sistemin IT.
 f) Lista e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.
 g) Të dhëna për linjat e shpërndarjes.

Nr.	Emërtimi i linjës	Kapaciteti transmetues	U _n	I _n	Lloji/ seksioni i përcjellësve	Gjatësia	Numri i shtyllave	Numri i qarqeve të linjës	Viti i ndërtimit
		MW	kV	A	mm ²	km			

- h) Të dhëna për n/st e sistemit të shpërndarjes

Nr.	Emri i n/st	Nr. i njësive transformuese	Fuqia e instaluar	U _n	I _n	Humbjet e energjisë	Skema e lidhjes së pështjellave	Niveli i rregullimit të tensionit	Tipi i rregullimit të tensionit	Viti i ndërtimit
			kVA	kV	A	%				

- i) Të dhëna për përdoruesit e lidhur në sistemin e shpërndarjes dhe energjinë e shpërndarë

Nr.	Kategoritë	Nënkategoritë	Numri i konsumatorëve	Sasia e energjisë				
				GWh				
				Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V
	U _n	220 V						
		0.4 kV						
		6 kV						
		10 kV						
		20 kV						
		35 kV						
		110 kV						
	Fuqia e instaluar e konsumatorëve	0-5 kVA						
		>5-10 kVA						
		>10-50 kVA						
		>50-100 kVA						
		>100-500 kVA						
		>500-1000 kVA						
		>1-10 MVA						
	Aktiviteti	>10-50 MVA						
		Familjare						
		Buxhetore						
		Private						
		<i>Specifikoni...</i>						

- j) Të dhëna për përdoruesit e lidhur në sistemin e shpërndarjes (gjeneruesit)

Nr.	Emri i përdoruesit	Fuqia e instaluar	U _n	I _n	Lloji i lidhjes (zbara të n/st, linjë etj.)	Tipi i matjes	Vendndodhja e aparateve matëse
		MW	kV	A			



k) Të dhëna për kabinat e transformimit

Nr.	Fuqia e instaluar	Numri i kabinave	Numri i konsumatorëve të lidhur	Humbjet e energjisë
	kVA			%
	10			
	20			
	30			
	40			
	50			
	100			
	180			
	200			
	250			
	320			
	400			
	560			
	630			
	750			
	1000			

4.7 Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike

a) Të dhëna për sigurimin e energjisë elektrike për furnizimin e klientëve

Nr.	Subjekti (central prodhues, tregtar etj.)	Sasia e energjisë së kontraktuar				
		GWh				
		Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V

b) Kapitali financiar për ushtrimin e këtij aktiviteti.

c) Lista e kontratave aktuale dhe të mëparshme për blerjen dhe sigurimin e energjisë elektrike.

d) Informacion i detajuar tekniko-financiar lidhur me përmbushjen e këtyre kontratave.

e) Sistemin IT.

f) Lista e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

a) Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar

Nr.	Kategoritë	Nënkategoritë	Numri i konsumatorëve	Sasia e energjisë				
				GWh				
				Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V
	U _n	220 V						
		0.4 kV						
		6 kV						
		10 kV						
		20 kV						
		35 kV						
		110 kV						
	Fuqia e instaluar e konsumatorëve	0-5 kVA						
		>5-10 kVA						
		>10-50 kVA						
		>50-100 kVA						
		>100-500 kVA						
		>500-1000 kVA						
		>1-10 MVA						
		>10-50 MVA						



Aktiviteti	Familjare							
	Buxhetore							
	Private							
	<i>Specifikoni...</i>							

b) Niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët.

c) Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti.

4.8 Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

a) Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t'u tregtuar në GWh.

b) Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare), i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti.

c) Lista e kontratave të mëparshme të realizuara (nëse ka pasur).

d) Sasitë e energjisë elektrike që do të tregojë sipas viteve.

4.9 Dokumentacioni teknik për aktivitetin e operimit të tregut të energjisë elektrike.

a) Lista e të punësuarve, profesioni, formimi.

b) Dëshmi për posedimin e harduerit dhe softuerit të nevojshëm për komunikimin me të gjitha pikat e matjes, si dhe me të gjithë pjesëmarrësit në treg (klientët e tyre).

c) Lista e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

4.10 Dokumentacioni teknik për aktivitetin e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike.

a) Elementet e sistemit të mbyllur të shpërndarjes.

b) Burimin e furnizimit me energji elektrike të këtij sistemi.

c) Klientët e këtij sistemi me fuqitë e instaluar përkatese.

d) Demonstrimin se burimi i furnizimit me energji elektrike mbulon konsumin e klientëve të këtij sistemi.

Neni 10

Shqyrtimi i aplikimit

1. Pasi shqyrton aplikimin e paraqitur, lidhur me

plotësimin e kërkesave të neneve 8 dhe 9, personat e ngarkuar nga drejtoria përgjegjëse përgatit një relacion ku i propozon Bordit të ERE-s fillimin ose jo të procedurave për shqyrtimin e aplikimit në përputhje me afatet e përcaktuara në rregullat për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s dhe në këtë rregullore.

2. Çdo aplikim do të paraqitet në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregullore duke plotësuar kërkesat dhe dokumentet e kërkuara në të. Në të kundërt, Bordit të ERE-s i propozohet mosfillimi i procedurave të shqyrtimit të aplikimit.

3. Bordi i ERE-s mund të vendosë për fillimin ose jo të procedurave për shqyrtimin e aplikimit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në relacionin e sipërpërmendur.

4. ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4, të nenit 8, të kësaj rregulloreje, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatese nga institucionet e tjera.

5. Në rast refuzimi, ERE do të njoftojë aplikuesin lidhur me arsyet e refuzimit dhe duke i dhënë udhëzimet e nevojshme brenda 7 ditë pune nga marrja e vendimit.

6. Aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe duke marrë në konsideratë udhëzimet e ERE-s.

7. Nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6 të këtij neni brenda 1 muaji nga marrja e vendimi për mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

8. Në rast të miratimit të fillimit të procedurave për shqyrtimin e aplikimit, brenda 2 ditëve pune



nga marrja e vendimit ERE publikon në median e shkruar për dy ditë me radhë një njoftim për aplikimin e paraqitur në tri gazeta të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin që botohen në Tiranë. Çdo njoftim për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike do të përmbajë shkurtimisht të dhënat lidhur me fuqinë e instaluar vendndodhjen dhe territorit ku kryhet veprimtaria e licencuar.

9. Njoftimi përmban

a) një informacion të shkurtër për aplikimin e paraqitur;

b) një njoftim që paraqitja e objeksioneve ose ankesave nga personat e interesuar mund të bëhen në ERE brenda afateve të përcaktuara nga kjo rregullore.

10. Pas publikimit në media të njoftimit, ERE do të sigurojë që për një periudhë 30 ditë pune nga data e parë e publikimit të njoftimit për aplikimet për licencim në aktivitetin e prodhimit, aplikimi dhe të gjitha dokumentet shoqëruese apo çdo informacion tjetër janë të disponueshme për inspektimin e publikut në zyrat e saj.

11. Për centralet e lidhur drejtpërdrejt me rrjetin e shpërndarjes dhe licencat e tjera në përputhje me nenin 39, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, periudha e përcaktuar në pikën 10, do të jetë 10 ditë pune.

12. Me vendim të Bordit të ERE-s, duke marrë parasysh pretendimet e aplikuesit, mund të vendoset që informacione ose dokumente që mund të shkaktojnë dëm tregtar ndaj aplikuesit, të mbahen konfidenciale dhe mund të ndalojë inspektimin e tyre nga ana e palëve të treta.

13. Në çdo rast ERE njofton aplikuesin për objeksionet e paraqitura ndaj aplikimit për të cilin kanë filluar procedurat e licencimit dhe kërkon sqarime nga aplikuesi për objeksionet e paraqitura nga palët e interesuara.

Neni 11

Plotësimi dhe paraqitja e informacionit shtesë

1. Duke filluar nga data e publikimit të parë në media të njoftimit për aplikimin deri në përfundim të afateve të përcaktuara në nenin 10, pikat 10 dhe 11, ERE mund t'i kërkojë aplikuesit të paraqesë informacion shtesë, në formën dhe në përmbajtjen e caktuar brenda një afati të caktuar, lidhur me çdo çështje që ERE e konsideron të nevojshme.

2. Nëse aplikuesi nuk paraqet informacionin shtesë brenda afatit, formës dhe përmbajtjes së caktuar, kjo do të përbëjë kusht për refuzimin e aplikimit.

Neni 12

Kontrolli i saktësisë së të dhënave të paraqitura nga aplikuesi

1. Pas përfundimit të periudhës së marrjes së objeksioneve sipas nenit 10, pikat 10 dhe 11 të kësaj rregullore, drejtoria/drejtoritë përgjegjëse do të analizojë të gjitha objeksionet e mundshme të dërguara nga palë të treta, dokumentet e depozituara (aplikimi) nga aplikuesi, si dhe çdo informacion shtesë të marrë me kërkesë të ERE-s, nëse përputhen me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Pas kontrollit të dokumentacionit, personi i ngarkuar nga drejtoria/drejtoritë përgjegjëse do t'i paraqesë Bordit të ERE-s një raport, duke sugjeruar pranimin ose refuzimin e aplikimit përkatës, si dhe arsyetimet përkatëse në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Vendimarrja e Bordit

1. Pas përfundimit të afatit për paraqitjen e objeksioneve ose ankesave, Bordi i ERE-s shqyrton kërkesën për aplikim dhe relacionin e paraqitur për këtë aplikim nga personi/at e ngarkuar nga drejtoria përgjegjëse në përputhje me kriteret e specifikuar në nenin 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe kësaj rregullore.

2. Në marrjen e vendimit për licencimin ose refuzimin e licencimit të një subjekti aplikues, Bordi i ERE-s merr në konsideratë kriteret e mëposhtme:

a) plotësimin dhe saktësinë e dokumentacionit të paraqitur në përputhje me sa përcakton kjo rregullore ose/dhe kërkesat për informacion shtesë të ERE-s;

b) vendndodhjen dhe territoret në të cilat do të kryhet veprimtaria;

c) funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshme të impianteve të pajisjeve dhe/ose të rrjetit;

d) kërkesat për llojin e burimeve parësore të energjisë;

e) kërkesat lidhur me sigurinë kombëtare jetën e qytetarëve pasurinë shëndetin dhe rendin publik;

f) kërkesat financiare;

g) mbrojtjen e mjedisit;



h) nxitjen e eficiencës së energjisë në sektorin e energjisë elektrike;

i) detyrimet e shërbimit publik siç parashikon ligji;

j) nxitjen e tregut konkurrues të energjisë elektrike dhe parimet e kostos më të ulët në furnizimin me energji elektrike;

k) efektin ndaj sigurisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Në marrjen e vendimit të tij, Bordi i ERE-s shqyrton:

a) aplikimin, si dhe çdo informacion shtesë të paraqitur nga aplikuesi;

b) çdo objeksion ose ankesë të paraqitur nga personat e interesuar;

c) relacionin e hartuar nga personi/at e ngarkuar nga drejtoria/drejtoritë përgjegjëse.

Neni 14

Pranimi ose refuzimi për licencim i aplikuesit

1. Bordi i ERE-s e merr vendimin përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit brenda 60 ditëve pune nga data e publikimit të parë të njoftimit për aplikimin në shtyp, duke e bazuar atë në kriteret e specifikuar në nenin 13 të kësaj rregulloreje.

2. Për centralet e lidhur drejtpërdrejt me rrjetin e shpërndarjes dhe për të gjitha licencat e tjera Bordi merr vendim jo më vonë se 30 ditë pune nga data e publikimit të parë të njoftimit për aplikimin në shtyp, duke e bazuar atë në kriteret e specifikuar në nenin 13 të kësaj rregulloreje.

3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune.

4. Për rastet e tjera të aplikimit zbatohen afatet dhe procedurat e përshkruara në nenet 15, 16 dhe 17.

5. Vendimi i komunikohet aplikuesit nëpërmjet një njoftimi me shkrim dhe do të përmbajë arsyetimin përkatës në të cilin është bazuar vendim-marrja.

6. Vendimi i ERE-s i dhënë sipas kësaj rregullore publikohet në Fletoren Zyrtare.

7. Vendimi i ERE-s mund të apelohej në Gjykatën Kompetente nga aplikuesi ose çdo palë e tretë e interesuar.

KAPITULLI III

MODIFIKIMI, RINOVIMI DHE TRANSFERIMI I LICENCËS

Neni 15

Modifikimi i licencës

1. Në përgjigje të çdo kërkesë të të licencuarit ose me iniciativën e vet, ERE mund të modifikojë termat dhe kushtet e një licence, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. ERE mund të vendosë modifikimin e licencës në rastet e mëposhtme:

a) me iniciativën e saj kur ka ndryshime të rrethanave të lëshimit të licencës (kuadri ligjor, kushtet e kontratës koncesionare, vendime të gjykatës) ose të disa ngjarjeve që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, tregtimin e energjisë elektrike ose tregun e energjisë elektrike;

b) me kërkesë të të licencuarit.

3. Nëse ERE vendos të ndryshojë një licencë, duhet t'i lëshojë të licencuarit një licencë me përmbajtje të ndryshuar, duke shfuqizuar pjesët e ndryshuara të licencës së mëparshme.

4. Në rastin e modifikimit/ndryshimit të licencës me kërkesë të të licencuarit, ERE zbaton të njëjtat afate dhe procedura si për licencimin duke kërkuar informacionin e mëposhtëm:

a) një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës;

b) vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës;

c) miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera;

d) ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi;

e) të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE.

Neni 16

Rinovimi i licencës

1. Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë,



personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës duke paraqitur dokumentet e mëposhtme:

- a) formatin e aplikimit sipas nenit 9, pika 1;
- b) dokumentet juridike administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2;
- c) dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3;
- d) çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.

2. ERE mund të kërkojë nga subjekti çdo informacion shtesë të konsideruar të nevojshëm për procesin.

3. Kriteret për marrjen e vendimit nga Bordi janë të njëjta si në rastin e një licencimi.

4. ERE publikon në median e shkruar një njoftim për aplikimin për rinovimin e licencës sipas të njëjtave procedura që aplikohen dhe për kërkesat për licencim në sektorin e energjisë.

5. Bordi mund të marrë në konsideratë në rastin e rinovimit të licencës edhe përmbushjen e kushteve të licencës në aktivitetin e licencuar nga aplikuesi.

6. Bordi do të marrë vendimin për rinovim ose jo të licencës jo më vonë se 20 ditë pune nga fillimi i procedurave për shqyrtimin e një aplikimi, konform kësaj rregullore.

7. Të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE. Mosplotësimi i këtij kushti përbën shkak për sankionim sipas parashikimeve të nenit 5 të rregullores “Për vendosjen e gjobave dhe kushtet e lehtësimit prej tyre”.

Neni 17

Transferimi i plotë dhe i pjesshëm i licencës

1. Me kërkesë të të licencuarit ERE dhe/ose me iniciativën e saj mund të transferojë plotësisht dhe pjesërisht licencën e një të licencuari në përputhje me ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. Në rastet e transferimit të plotë të aseteve sipas rregullores së miratuar nga ERE për këtë qëllim, personit jo të licencuar tek i cili do të transferohen asetet do t’i transferohet licenca, pasi ai të paraqesë një aplikim në ERE për transferimin e licencës duke paraqitur dokumentet e mëposhtme:

- a) formatin e aplikimit sipas nenit 9, pika 1;
- b) dokumentet juridike administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2;

c) dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3;

d) çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.

3. Në rastin e transferimi të pjesshëm të aseteve, ERE zbaton të njëjtat procedura si për transferimin e plotë të përshkruar në pikën 2, por para se të vendosë për licencimin e personit tek i cili do të transferohen pjesërisht asetet, do të kryejë modifikimin e licencës të personit të licencuar që ka kryer transferimin e pjesshëm të aseteve.

4. Në rastin e kërkesës nga i licencuari për transferimin e licencës jo sipas rastit të parashikuar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, i licencuari duhet të paraqesë në ERE këto dokumente:

- a) formatin e aplikimit sipas nenit 9, pika 1;
- b) një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës;
- c) vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës.

5. Subjekti i cili kërkon t’i transferohet licenca nga i licencuari sipas pikës 4, duhet të paraqesë një aplikim sipas pikës 2 të këtij neni, pasi ERE të ketë marrë vendim për pranimin e aplikimit sipas pikës 4 të paraqitur nga i licencuari.

6. Pas miratimit të fillimit të procedurave për shqyrtimin e aplikimit për transferimin e licencës ERE publikon në median e shkruar një njoftim për aplikimin për transferimin e licencës sipas të njëjtave procedura që aplikohen dhe për aplikimet për licencim në sektorin e energjisë.

7. ERE merr vendim për pranimin ose jo të aplikimit brenda 45 ditë pune nga fillimi i procedurave për shqyrtimin e një aplikimi dhe gjatë kësaj periudhe i licencuari do të vazhdojë kryerjen e shërbimit në përputhje me kuadrin ligjor.

8. Në rastin e procedurave të transferimi të aseteve subjekti aplikues duhet të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE.

Neni 18

Heqja e licencave

Me iniciativë të ERE-s, personave të interesuar apo mbajtësit të licencës, ERE fillon procedurën për heqjen e licencës në zbatim të parashikimeve të rregullores për procedurat e heqjes së një licence.



KAPITULLI IV LËSHIMI DHE REGJISTRIMI I LICENCEVE

Neni 19

Forma e regjistrimit

1. Pas marrjes së vendimit nga ERE për licencimin, transferimin e plotë/të pjesshëm, rinovimin apo modifikimin e licencës, aplikuesit i lëshohet licenca përkatëse.

2. Licencat e lëshuara për kryerjen e aktiviteteve në sektorin e energjisë elektrike do të regjistrohen nga ERE në regjistrin e licencave.

3. Regjistri i licencave mbahet me shkrim dhe në mënyrë elektronike nga sekretaria e Bordit të ERE-s.

4. Në regjister futen detajet e mëposhtme:

- numri dhe seria e licencës;
- data e miratimit të licencës;
- data e lëshimit të licencës;
- emrin e të licencuarit;
- vendndodhjen e të licencuarit;
- përshkrimin e aktivitetit, i cili është objekt i licencës së lëshuar;
- kohëzgjatja e licencës;
- vendimi i Bordit.

Neni 20

E drejta për t'u informuar mbi përmbajtjen e regjistrimit

1. Regjistri i licencave është i hapur për publikun. E drejta e inspektimit të regjistrimit jepet vetëm në ambientet e ERE-s.

2. E drejta e hyrjes në dosjen e dokumenteve shoqëruese u jepet personave me interes ligjor siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi.

3. Informacioni konfidencial ose i biznesit nuk do të jetë i disponueshëm për inspektim ose shqyrtim publik, përderisa publikimi i tyre mund të sjellë dëme ekonomike.

KAPITULLI V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21

Periudha tranzitore

Të gjitha aplikimet që janë paraqitur në ERE para hyrjes në fuqi të kësaj rregullore do të trajtohen sipas dispozitave të rregullores së mëparshme.

Neni 22

Amendamente të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga Bordi i ERE-s.

ANEKSI A

PAGESA E REGJISTRIMIT DHE PROCEDIMIT TË NJË APLIKIMI

Aktiviteti	Licencim	Modifikim	Rinovim	Transferim
Prodhimin e energjisë elektrike	30 000 lekë/MW	50 000 lekë	50 000 lekë	50 000 lekë
Operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike	1000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Furnizimin e energjisë elektrike	1000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Operimin e tregut të energjisë elektrike	1000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Sistemet e mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike	1000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Tregtimin e energjisë elektrike	40 000 lekë	30 000 lekë	30 000 lekë	30 000 lekë

**VENDIM****Nr. 111, datë 1.7.2016****MBI LËNIEN NË FUQI TË
VENDIMEVE NR. 139, NR. 141, NR. 145,
NR. 146, NR. 147, NR. 148, DATË 26.12.2014,
TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-s, PËR PERIU DHËN 1 KORRIK
2016–31 DHJETOR 2016**

Në mbështetje të neneve 10, pika 2; 16; 20, germa “c” dhe 109, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM-së nr. 244, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 22 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.7.2016, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike,

konstatoi se:

- Problematika e marrëdhënieve të ndërsjella, që ishte një nga shkaqet kryesore të mosaxhustimit të të ardhurave që i përkasin periudhës 2012–2014, si dhe vendimit nr. 156, datë 24.12.2015, vazhdon të ekzistojë.

- Asnjë nga kompanitë nuk ka paraqitur axhustime të periudhave të mëparshme të vitit 2015, si dhe 6-mujorit të parë të vitit aktual.

- Aplikimi i OSHEE-së dhe OST-së konsiston në llogaritje të të ardhurave të kërkuara për periudhën njëvjeçare.

- Mungesa e mbajtjes së llogarive të ndara për aktivitetin e shpërndarjes dhe të furnizimit apo dhe alokimi i kostove reale në nivelin tensioni, si pasojë e vështirësive që paraqet mbajtja e llogarive në kompani.

- Aktiviteti i furnizimit universal (furnizim me pakicë) tashmë duhet të reflektojë dhe kostot e aktivitetit të transferuar nga FPSH-ja nga data 1 korrik 2016. Në lidhje me këtë transferim nuk disponojmë asnjë dokument apo vendim të pronarit për mënyrën e transferimit të aktivitetit, duke përfshirë dhe kostot përkatëse.

- Në lidhje me përcaktimin e të ardhurave të kërkuara të aktivitetit të gjenerimit duhet të bëhet

në përputhje me metodologjinë përkatëse, në respekt të ligjit nr. 43/2015 dhe VKM-së nr. 244, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”. Siç vërehet nga aplikimi i KESH sh.a. të ardhurat e kërkuara për aktivitetin e prodhimit publik, përfshijnë dhe elemente të të ardhurave të përcaktuara në metodologjinë e FPSH-së.

- Metodologjitë e reja në përputhje me modelin e përkohshëm të tregut janë akoma në proces rishikimi në bashkëpunim me konsulencën e USAID-i dhe konsultimi me Sekretariatën e Vjenës.

- Një situatë financiare e përmirësuar e të tria kompanive, si dhe në likuiditetet përgjatë 6-mujorit të parë të vitit 2016.

- Mbështetur në nenin 10, pika 2, të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe kjo e fundit në seancën zyrtare publike është shprehur pro shtrirjes së efektit të tarifave dhe çmimeve aktuale të energjisë elektrike edhe për 6-mujorin e dytë të vitit 2016.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të lërë në fuqi deri për periudhën 1 korrik 2016 deri më 31 dhjetor 2016, tarifatat dhe çmimet e energjisë elektrike, të miratuara përkatësisht me vendimet si më poshtë:

- Vendimin nr. 139, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2015”.

- Vendimin nr. 141, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës për shërbimet ndihmëse të KESH sh.a. për vitin 2015”.

- Vendimin nr. 145, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2015”.

- Vendimin nr. 146, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015 në nivelin e tensionit 35 kv”.

- Vendimi nr. 147, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës mesatare të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015”.



- Vendimi nr. 148, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015”.

2. OSHEE sh.a. për periudhën e mbetur të vitit 2016, përveç shlyerjes së detyrimeve korrente, të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a. nga detyrimet e prapambetura për qëllime të pagesave të kredive nga OST sh.a. dhe KESH sh.a.

3. Përditësimi dhe kompensimi i të gjitha efekteve të mundshme financiare për të licencuarit për periudhën 2015 dhe vitin 2016 do të bëhet në periudhën pasardhëse.

4. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 3781, datë 4.7.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit, “Rikonstruksion i rrugës “Mujo Ulqinaku” dhe “Rehabilitimi i fasadave”, Fier.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 2 403 668 (dy milionë e katërqind e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

ZËVENDESMINISTRI
I ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

VLERESIME PARAPRAKE PER PASURITE PRONE PRIVATE QE DO TE SHPRONESOHEM PER EFEKT TE REALIZIMIT TE PROJEKTEVE PER INTERES PUBLIK

Lista emërore e pronareve, pasurite e të cileve do të shpronësohen për realizimin e projektit “Rikonstruksion i rrugës Mujo Ulqinaku dhe hapësirave përreth saj dhe rehabilitimi i fasadave” Fier

Nr.	Emer Mbiemer	Zona Kadastrale	Nr. Pasurise	Sip. Pergj. Truallit (m²)	Sip. Prekur Truallit (m²)	Cmimi per truallin (leke / m²)	Vlera e truallit (leke)	Sip. Totale Ndertes me certificate (m²)	Sip. Prekur Ndertes (m²)	Amortizim i (%)	Vlera e Ndertes me preventiv (leke)	Vlera e Pergjith. (leke)	Gjendja juridike e pasurise
1	Mynevere Alush Gilani & 5 b/pronare	8533	3/883	1,855.0	218.0	11,026	2,403,668	-	-	-	-	2,403,668	Konfirmim nga Z.V.P.P
Vlera Totale												2,403,668	

Vlerësimi është bërë duke zbatuar VKM nr.138 date 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive prone private që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik" dhe VKM nr. 89 date 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerësimit të tokës në Republikën e Shqipërisë"

KËRKESË

Nr. 3887, datë 8.7.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim asfaltim rrugë e sheshe, blloqet e banimit Sheja+regu i qytetit, Faqe| 10504

Shkumbini dhe Ushtaraku”, Librazhd.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Librazhd.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së



masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 370 690 (treqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI
I ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

BASHKIA LIBRAZHD

LISTA E PRONAREVE QË SHPRONESOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIM ASFALTIM RRUGE E SHESHE ,BLLOQET E BANIMIT TREGU QYTETIT +SHEJA, SHKUMBINI DHE USHTARAKU"

LIBRAZHD

Nr	Pronari	ZK	Nr. pasurise	Lloji pasurise	Siperfaqe truall m2	Çmimi i truallit leke/m2	Vlera truallit	Vlera objektit leke	Vlera totale e shpronësimit leke	Shenime
1	Tahir Destan Bahiti	2446	10/209	Truall	48	2,898	139,104	231,586	370,690	Konfirmuar nga ZVRPP

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë